



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe veterinarisë

**Departamenti:** Pemëtari - Vreshtari

**Programi:** Pemëtari Vreshtari

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Diellza Kryeziu, me titull:  
**“Hulumtimi i mbirjes së kokrrave të polenit te kultivari i kumbullës Stanley”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 02 deri me datë 09.12.2023.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Gëzim Hodolli anëtarë, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu , përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI**

**PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI**



Tema:

**“HULUMTIMI I MBIRJES SË KOKRRAVE TË POLENIT TE KULTIVARI I  
KUMBULLËS STANLEY ”**

Mentor:

***Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu***

Kandidati:

***Bsc. Diellza Kryeziu***

Prishtinë, 2023

## ABSTRAKTI

Studimi është kryer në vitin 2023 në fermën didaktike të FBV-së dhe në laboratorin e Pemëtarisë. Në këtë studim është prezantuar hulumtimi i mbirjes së kokrrave të polenit tek kultivari i kumbullës Stanley. Njëkohësisht në këtë hulumtim është përfshirë edhe formimi dhe zhvillimi i frutave në bimët ku janë marrë lulet për hulumtim si dhe ndikimi i faktorëve klimatik në këtë proces. Pjalnimi dhe pllenimi janë bazat kryesore mbi të cilat zhvillohet frutifikimi i suksesshëm i kumbullës. Mbirja e kokrrave të polenit është një prej proceseve më të rëndësishëm gjatë pllenimit që rezulton me formimin e farës dhe zhvillimin e frytit. Si një proces i ndërlikuar mbirja e kokrrave të polenit ndikohet nga shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Ky studim ka për qëllim të vë në pah ndikimin e disa prej këtyre faktorëve në mbirjen e polenit te kultivari i kumbullës Stanley, në kushtet agrometeorologjike të Prishtinës. Gjatë procesit të hulumtimit është përdorur metoda e “pikës së varur” përkatësisht përdorimi i tretësirës së saharozës si teren ushqyese për mbirjen e kokrrave të polenit. Lulet janë marrë në tri fenofaza të lulëzimit: fillimi i lulëzimit, lulëzimi i plotë dhe përfundimi i lulëzimit, pastaj kokrrat e polenit të veçuara nga anterat janë vendosur në tretësirat e saharozës me përqendrim 10%, 15% dhe 20%. Prosesi i mbirjes është vëzhguar në përmes mikroskopit elektronik për 120 minuta (10’ 20’ 30’ 40’ 50’ 60’ dhe 120’), dinamika e mbirjes së polenit është regjistruar përmes fotografive të realizuara përmes kamerës së mikroskopit. Gjatë hulumtimit të mbirjes së kokrrave të polenit është vërejtur se një pjesë e kokrrave të polenit nuk arrijnë të mbijnë, një pjesë arrijnë vetëm të fillojnë mbirjen pastaj gypi gjerminativ nuk zgjatet, një pjesë tjetër para ose pasi të fillojnë të mbijnë dhe gjatë zhvillimit të gypi gjerminativ shpërthen (aborton) dhe një pjesë tjetër arrin të zhvilloj normalisht gypin gjerminativ. Në përgjithësi kokrrat e polenit më së tepërmi janë aktivizuar në përqendrimin e saharozës 10%. Gjatë 120 minutave të mbikëqyrjes së mbirjes së kokrrave të polenit, në periudhën 10 – 30 minuta ka ndodhë pjesa dërmuese e fillimit të mbirjes së kokrrave të polenit, abortimi ka ndodhë në të gjitha fazat e periudhës prej 120 minutave ndërsa mbirja e plotë më së tepërmi ka ndodhë në periudhën prej 50 minutave. Në të gjitha fazat e lulëzimit aktivizimi i kokrrave të polenit ka qenë mjaft i ulët qoftë në inicim të mbirjes, abortimit apo mbirjes së plotë, kjo mund të ndërlidhet me kushtet klimatike specifike që kanë mbretëruar në vitin 2023, ngricat në fillim të lulëzimit dhe reshjet e vazhdueshme që e kanë shoqëruar periudhën e lulëzimit dhe formimit të

frytit. Kjo shkallë kaq e ulët e mbirjes së kokrrave të polenit është reflektuar edhe me përqindjen e ulët të formimit të frutave, ku vetëm 6.52 % e luleve kanë formuar fruta.

Fjalët kyçe: Kumbulla, polenit, mbirja, saharoza, lulëzimi.